

PROCEDURA QË NDJEKIN FUNKSIONARËT E LARTË TË AP PËR TË MARRË VENDIME

Në mbështetje të **ligjit me Nr.10 303, datë 15.7.2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)”**, neni 2, pika 2 dhe 3, ku parashikohet se:

“ 2 .AIDA është person juridik, publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë, dhe drejtohet nga bordi drejtues ”.

“ 3. AIDA vepron për përmbushjen e qëllimeve të saj, në bazë të parimeve të përcaktuara në këtë ligj,në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me statutin e saj.”

Gjithashtu sipas Kreut III, neni 10, përcaktohet se:

“...Organet drejtuese të Agjencisë janë: a) bordi drejtues; b) kryetari i bordit drejtues; c) drejtori ekzekutiv”

Neni 11,12 dhe 13 përcaktojnë qartazi kompetencat, vendimarrjen dhe përbërjen e Bordit Drejtues. Ndërkohë që Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s zgjidhet nga ky i fundit dhe raporton sipas përcaktimeve ligjore tek Bordi Drejtues, si dhe të Ministri Përgjegjës për Financat si institucion në varësi.